



BANKA E SHQIPËRISË

SHQETËSIMET E VENDEVE TË ARDHSHME ANËTARE TË ERM II

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë
z. Ardian Fullani

Në konferencën e organizuar nga Banka Kombëtare e Polonisë “Misioni i një banke
qendrore bashkëkohore”

Varshavë, 15 dhjetor 2006

Banka e Shqipërisë

Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë,

Integritet Evropian dhe Komunikimit

Sheshi “Skënderbej”, Nr. 1, Tiranë

Tel: 04/222 152, Faks: 04/ 223558

Internet: www.bankofalbania.org

E-mail: zyraeshtypit@bankofalbania.org

I nderuar z. Balcerowicz,
Të nderuar Guvernatorë,
Të nderuar kolegë,
Zonja dhe zotërinj,

Gjej rastin të falenderoj z. Balcerowicz dhe Bankën Kombëtare të Polonisë për ftesën e bërë. Është një nder për mua që marr pjesë në këtë diskutim dhe që më jepet mundësia të ndaj mendimet e mia lidhur me sfidat me të cilat përballen vendet e ardhshme anëtare të ERM II.

Tema qendrore e kësaj konference – misioni i bankës bashkëkohore qendrore me fokus adoptimin e euros – ka një rëndësi të madhe për vendet që aspirojnë anëtarësimin në familjen e madhe evropiane në një të ardhme jo shumë të largët. Duke marrë parasysh përvojën e vendeve tashmë anëtare, si dhe të atyre që priten të bëhen anëtare të saj, anëtarësimi në këtë familje është një proces mjaft kompleks dhe sfidues.

Mekanizmi ERM II ka tërhequr mjaft interes dhe kritikë akademike, duke qenë se konsiderohet si një provë e konvergimit të treguesve nominalë të një vendi. Në aspektin konceptual, ERM II paraprin në mënyrë të drejtpërdrejtë integrimin e plotë në EMU.

(I) ERM II si një hap drejt EMU

Duke e vendosur ERM II në kontekstin e duhur, duhet të jemi të qartë për faktin se ai është një hap i nevojshëm paraprak përpara adoptimit të euros. Për këtë arsye, anëtarësimi në ERM II është i kushtëzuar nga gatishmëria ekonomike dhe politike e një vendi për t'u anëtarësuar në EMU. Këtu duhen konsideruar disa aspekte: Me adoptimin e një monedhe të vetme, një shtet heq dorë nga ndjekja e një politike të pavarur monetare dhe banka qendrore nuk mund të veprojnë si huadhënësi i fundit. Humbja e pavarësisë së politikës monetare mund të jetë problematike, nëse një vend

ka arritur pak në aspektin e konvergimit real (si strukturor ashtu dhe ciklik) dhe nëse ai është i ndjeshëm ndaj goditjeve asimetrike. Nga ana tjetër, humbja e funksionit të huadhënësit të fundit nga bankat qendrore kombëtare nënkupton kosto të mëdha dhe të zgjatura fiskale në rastin e krizave financiare. Për këtë arsye, për anëtarësimin në bashkimin monetar do të nevojitej një sistem financiar i shëndoshë dhe i qëndrueshëm.

Është pjesërisht një pasqyrim i këtyre sfidave ekonomike arsyeja pse anëtarët e rinj të BE-së duken se ndjekin trajektore të ndryshme drejt EMU-së. Nga njëra anë, Sllovenia, Vendet Balltike, Malta, Qipro dhe Sllovakia janë bërë anëtare të ERM II, me synim anëtarësimin në EMU në të ardhmen. Ndërkohë që, vendet e tjera, veçanërisht vendet më të mëdha të Evropës Qendrore, kanë zgjedhur të qëndrojnë jashtë ERM II, me qëllim që t'i japin vetes më tepër kohë për të bërë axhustimet e nevojshme ekonomike.

(II) Sfidat e ERM II

Vendi kandidat mund të vendosë të anëtarësohet në mekanizmin ERM II menjëherë sapo aspekti ekonomik dhe konsensusi politik të jenë mjaft të konsoliduara për të mbështetur anëtarësimin në EMU. Por, çfarë mund të mos funksionojë mirë për vendet anëtare gjatë ERM II? Disa çështje mjaft të diskutuara lidhen me konsolidimin fiskal, stabilitetin financiar si dhe me zgjedhjen e paritetit qendror. Më lejoni të them pak fjalë lidhur me këto çështje.

- Një nga pesë kriteret e konvergimit (nominal) të Mastroihtit është qëndrueshmëria e kursit të këmbimit. Ndërkohë që, qëndrueshmëria e çmimit të konsumit, konvergimi i normës afatgjatë të interesit dhe konsolidimi fiskal, janë kushtet e tjera që një vend duhet të përmbushë me qëllim anëtarësimin në EMU. Është e qartë se barra e sigurimit të pajtueshmërisë me këto kushte nuk bie vetëm dhe

ekskluzivisht mbi autoritetet e politikës monetare. Politikat fiskale dhe ato të punës duhet të rradhiten përkrah objektivave të politikës monetare, ndërkohë që arritja e angazhimit politik lidhur me ERM II, bart një rëndësi mjaft të madhe. Për këtë, e konsideroj si një arritje të lavdërueshme praktikën e dialogut të politikave monetare dhe fiskale, siç parashikohet në Strategjitë e Anëtarësimit të disa prej këtyre vendeve.

- Paqëndrueshmëria financiare është identifikuar si një rezultat i mundshëm negativ i fiksimit të dyanshëm të kursit të këmbimit për vendet anëtare. Lulahshmëria e kufizuar e kursit të këmbimit nën ERM II dhe kushtet deflacioniste i ekspozojnë vendet candidate në BE me flukse të mëdha kapitali hyrëse.¹ Nëse kursi i këmbimit në vendet candidate detyrohet të luhetet brenda një intervali relativisht të ngushtë, rezultati mund të ishte inflacion shtesë dhe i panevojshëm. Reagimi i bankës qendrore ndaj inflacionit në rritje do të kufizonte rritjen ekonomike. Një rezultat i tillë është akoma dhe më i mundshëm në praninë e efekteve Balassa-Samuelson, të përjetuara shpesh nga vendet me ekonomi në tranzicion.² Në një situatë të tillë, detyra e dyfishtë e ruajtjes së vlerës së brendshme dhe ndërkombëtare të monedhës mund të vihet në rrezik. Është pikërisht mbi këto kushte që ERM II vendoset nën sulm, si një periudhë panevojshmërisht e tejzgjatur.³ Për këtë arsye, nuk është e habitshme që disa vende candidate parapëlqejnë të jenë pjesë e tij për sa më pak kohë të jetë e mundur.
- Çështja e fundit që do të doja të diskutoja është përcaktimi i vlerës në të cilën do të fiksohet kursi i këmbimit. Implikimet e mundshme të një zhvendosjeje të kursit të këmbimit janë të konsiderueshme, duke qenë se barra korigjuese do të binte mbi sektorin real. Një zhvlerësim apo mbivlerësim i kursit të këmbimit do të rezultonte në një inflacion më të lartë ose në një rritje më të ulët ekonomike,

¹ Shiko Begg *et al.*, (2002).

² Vlen të kujtohet se Kriteret e Mastroihti u hartuan me qëllim sigurimin e konvergimit nominal të vendeve industriale me struktura ekonomike thuajse të ngjashme. Forca e tyre në sigurimin e konvergimit të vendeve me ekonomi në tranzicion është një çështje mjaft e debatueshme nga shumë ekonomistë (shiko Buiter *et al.*, 2002).

³ Shiko Buiter and Grafe (2002) dhe Begg *et al.* (2002).

derisa kursi real i këmbimit të rifitojë ekuilibrin e tij. Në mungesë të një kanali të kursit nominal të këmbimit, procesi i axhustimit ka për tendencë të jetë i ulët.

Tani, më lejoni të flas shkurtimisht lidhur me implikimet e politikës monetare që paraqesin çështjet e lartpërmendura.

Qëndrimi i politikës monetare të BQE-së lidhur me ERM II (ECB, 2003) thekson parësinë e objektivit të inflacionit mbi qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit. Anëtarësimi në EMU, në kontekstin e një regjimi të inflacionit të shënjestruar duket një alternativë mjaft bindëse e madje, e inkurajuar nga BQE. Megjithatë, periudha e qëndrimit në ERM II duhet të jetë sa më e shkurtër të jetë e mundur, me qëllim shmangien e papajtueshmërisë së qenësishme të këtyre dy objektivave përballë efekteve Balassa-Samuelson, si dhe përballë flukseve të mëdha hyrëse të kapitalit. Vendet që bëhen anëtare të EMU-së, e të cilat vijnë nga një regjim fiks i kursit të këmbimit, mund të kenë një perspektivë të ndryshme lidhur me këtë çështje. Megjithatë, edhe këto vende do të përjetojnë efektet Balassa-Samuelson, duke u përballur me vështirësinë e bashkërendimit të përmbushjes së kriterit të qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit dhe të çmimeve. Njëkohësisht, për shkak të intervaleve të gjera të luhatshmërisë të parashikuar nga ERM II, fitimi i kredibilitetit ka të ngjarë të jetë minimal.

(III) Implikimet e Politikës

Në përfundim, më lejoni të ritheksoj nevojën për një trajtim të kujdesshëm të EMU-së, duke qenë se nevojitet një shkallë e caktuar konvergimi real ekonomik dhe strukturor. Megjithatë, anëtarësimi në EMU nuk mund të shtyhet për mjaft kohë. Së pari, një shkallë me të vërtetë e lartë konvergimi ekonomik mund të kërkojë mjaft kohë për t'u arritur dhe njerëzit mund ta perceptojnë zgjerimin pa EMU-në si të paplotë. Së dyti, me adoptimin e monedhës së vetme, rreziku i kursit të këmbimit do të eliminohej, duke rezultuar në shtysa pozitive për zhvillimin e tregut financiar. Së treti, forcat e brendshme të tregut dhe integrimi

financiar, të përmendura në literaturë, mund të jenë një mbështetje shtesë e konvergimit real. As teoria ekonomike, e as praktikat e bankingut qendror nuk mund të ofrojnë një trajtim optimal të ERM II nga pikëpamja e regjimit monetar. Megjithatë, teoritë alternative pajtohen me nevojën e qëndrimit në të, për një periudhë sa më e shkurtër të jetë e mundur.

* * *

Në përfundim të fjalës sime, më lejoni të them pak fjalë lidhur me rastin e Shqipërisë.

(IV) Roli i Bankës së Shqipërisë në anëtarësimin e Shqipërisë në BE

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë përqendrohet në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve përmes kontrollit të agregatëve monetarë, të cilët përdoren si objektiva të ndërmjetëm. Për transmetimin e sinjaleve të normës së interesit dhe të likuiditetit në treg përdoren instrumentet indirekte. Norma e repos është treguesi kryesor për normat afatshkurtra të interesit, ndërkohë që për administrimin e likuiditetit përdoren operacionet repo dhe ato të repos së anasjelltë.

Gjatë pesë viteve të fundit, politika monetare e Bankës së Shqipërisë, e orientuar drejt stabilitetit të çmimeve, ka gjeneruar inflacion të ulët dhe të qëndrueshëm. Ajo gjithashtu, ka siguruar që pritshmëritë afatmesme dhe afatgjata të inflacionit të jenë nën kontroll.

Rritja ekonomike ka qenë e lartë, në rreth 5-6 për qind të PBB-së, si dhe ka patur një shkallë të lartë të stabilitetit financiar. *(Me fjalë të tjera, duket sikur jemi pothuajse afër arritjes së standardeve të ERM II.)* Rezultate të tilla pasqyrojnë mendimin se konvergimi ekonomik nuk duhet frenuar për shkak të konvergimit politik.

Proceset politike diktojnë që ERM II dhe EMU të paraprihen nga anëtarësimi në BE. Banka e Shqipërisë ka një pamje të qartë të procesit të anëtarësimit në BE. Hartimi i strategjive aktuale dhe të ardhshme lidhur me politikën monetare është në linjë me objektivin përfundimtar të anëtarësimit në BE.

- Në aspektin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë po bën përpjekjet e saj për ruajtjen e kushteve monetare në linjë me Kriteret e Mastroiit. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë po shqyrton me kujdes të gjitha alternativat e mundshme të regjimeve të politikës monetare, ndërmjet të cilave përparësi i është dhënë strategjisë së adoptimit të plotë të inflacionit të shënjestruar. Ky kuadër do të përmirësojë procesin e vendimmarrjes dhe do të krijojë një platformë më të mirë për komunikimin e angazhimit tonë lidhur me stabilitetin e çmimeve, i cili do të çojë në ankorimin më të mirë të pritshmërive të inflacionit. Megjithatë, zgjedhja e këtij regjimi të ri do të jetë një vendim i kushtëzuar nga rezultatet e kërkimeve të vazhdueshme aktuale, nga vlerësimi i parakushteve, si dhe nga ndërtimi i kapaciteteve. Për ta arritur këtë, po përmirësojmë me kujdes kapacitetet tona teknike dhe proceset vendimmarrëse, po zbatojmë parakushtet e nevojshme, po punojmë për arritjen e pavarësisë reale për politikën monetare, po përmirësojmë kapacitetet tona analitike, si dhe po ndërmarrim proceset e duhura të brendshme.
- Në aspektin strukturor, Banka e Shqipërisë po shtyn më tej axhendën e reformave në sektorin financiar. Axhenda e reformave në sektorin financiar synon zbatimin gradual të standardeve të *Acquis Communautaire* në legjisllacionin bankar. Për këtë, jemi duke rishikuar infrastrukturën ligjore. Banka e Shqipërisë po përgatit një draft të ri të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që së shpejti ajo do të nxjerrë një ligj të ri “Mbi letrat me vlerë”. Gjithshtu, po bëhen përpjekje për rishikimin e ligjit “Mbi fondet e pensionit dhe të investimit”, si dhe për hartimin e ligjit “Mbi sistemin e pagesave”, i cili do të zëvendësojë disa akte nënligjore të nxjerra deri tani nga Banka e Shqipërisë. Në përgjigje të rritjes së shpejtë të kredive dhe të intensifikimit të konkurrencës në sistemin bankar, rregulloret e natyrës prudente janë bërë më tepër shtrënguese. Ne po punojmë për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të atyre pjesëve të sektorit financiar shqiptar që ndodhen jashtë autoritetit të Bankës së Shqipërisë, ndërkohë që po bëjmë përpjekjet e duhura për të ruajtur konkurrencën e ndershme në këtë sektor. Banka e Shqipërisë po ndihmon Ministrinë e Financave për përmirësimin e kapaciteteve të saj të administrimit të borxhit. Unë besoj se

puna jonë do të pasqyrohet në një klasifikim të kënaqshëm të borxhit publik, i cili do të kryhet në fillim të vitit të ardhshëm. Kompetenca, kredibiliteti dhe profesionalizmi i politikës sonë monetare krijojnë kushtet e duhura për mbështetjen dhe garantimin e arritjes së objektivave ekonomike, si dhe për të përmbushur me sukses konvergimin e plotë ekonomik drejt parakushteve të ERM II. Megjithatë, arritjet tona nuk do të zgjasin për mjaft kohë në mungesë të një politike të kujdesshme fiskale dhe të një zgjerimi prudent fiskal. Banka e Shqipërisë nuk është aktori i vetëm kryesor ekonomik. Për këtë arsye, ne duhet të gjejmë dhe të zbatojmë ankora të qarta për të garantuar pajtueshmërinë e politikave ekonomike të aktorëve të tjerë. Në këtë drejtim, ne mund t'i shndërrojmë parakushtet e ERM II në një mbështetje të rëndësishme të huaj për të ruajtur kredibilitetin e reformave tona në të ardhmen. Si një vend përpara anëtarësimit, Shqipëria do të përballet me problemet e ERM II në periudhën afatmesme. Ne jemi mjaft të vetëdijshëm për rrugën e vështirë përpara nesh si dhe për sfidat me të cilat duhet të përballemi. Megjithatë, ne mbetemi të angazhuar për ndërmarrjen e reformave ekonomike dhe ligjore, duke i konsideruar ato si nisma të natyrshme në procesin e anëtarësimit në BE.

* * *

Referenca

Begg, B., Einchengreen, B., Halpern, L., Hagen, J. Wyplosz, CH. (2002). "Sustainable Regimes of Capital Movements in Accession Countries", CEPR.

Buiter, W.H. and Grafe, C. (2002). "Anchor, Float or Abandon Ship: Exchange Rate Regimes for the Accession Countries", EBRD 10 Year Anniversary Conference.

European Central Bank, (2003). "Policy Position of the Governing Council of the European Central Bank on Exchange Rate Issues Relating to the Acceding Countries.'